



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

5076
25-09-2023

Korçë, me 21.09.2023

SHPLLJE VENDIMI

Drejtuar : Njesise Administrative Lozhan Bashkia Maliq

Për: Alma Tahirllari dhe Endri Tahirllari
Me adrese: Fshati Lozhan i Ri Njesia Administrative Lozhan
Bashkia Maliq

Bashkalidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 649 dt. 07.09.2023 për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat 20 ditor, pasi dëftesat e komunikimit janë kthyer me shenimin " Larguar " dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli



U afishua ne Njesine Administrative Lozhan Bashkia Maliq
sot ne datë -----

(emër, mbiemër, firmë)

Nr. 126 P/2023
Dt. 27.09.2023
- J. A. Lozhan
- STIR P ✓
Dt. 25.09.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Nr.regj.them.23000-00784-41-2023 (1107)
Datë regj.23.05.2023

Nr.vendimi 41-2023-2658 (649)
Datë vendimi 07.09.2023

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me trup gjyqësor të përbërë prej:

Gjyqtarit të vetëm Seladin PYSQYLI, asistuar nga sekretare gjyqësore Vitoria Hajçe, në gjykatë, sot më datë 07.09.2023, përfundoi gjykimin e çështjes civile me palë dhe objekt:

KËRKUES: 1-Alma Tahirllari, e bija e Fredi dhe Mimoza, e datëlindjes 28.02.1999, lindur në fshatin Pirg dhe banuese në fshatin Lozhan i Ri, Njësia Administrative Lozhan, Bashkia Maliq.

2-Endri Tahirllari, i biri Petrit dhe Burbuqe, i datëlindjes 25.08.1996, lindur e banues në fshatin Lozhan i Ri, Njësia Administrative Lozhan, Bashkia Maliq.

OBJEKTI: Zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve.

Baza ligjore: Neni 125 e vijues i K.Familjes.

Në seancën e sotme gjyqësore, datë 07.09.2023, nuk u paraqit asnjë nga kërkuesit megjithse kishin dijeni të rregullt.

Gjykata, pasi verifikoi prezencën e palëve dhe u njoh me akt-njoftimet,

VËREN SE:

Me kërkesën drejtuar gjykatës, dy bashkëshortët kanë kërkuar zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok, duke paraqitur së bashku me kërkesën dhe një projekt marrëveshje në lidhje me zgjidhjen e pasojave për ta dhe fëmijën e mitur që kanë nga martesë.

Gjykata, pasi u njoh me kërkesën dhe aktet bashkëlidhur, referuar nenit 36/1 të K.Pr.Civile, konstatoi se shqyrtimi i kësaj çështje i përket juridiksionit gjyqësor civil dhe bazuar në nenin 41 të K.Pr.Civile kjo gjykatë ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e saj. Kjo gjykatë ka edhe kompetencën tokësore, pasi është gjykata e vendit ku bashkëshortët kanë lidhur martesën dhe kanë vendbanimin e përbashkët.

Bazuar në nenin 134 të K.Familjes, Gjykata thirri palët në seancë për pajtim, ku u paraqitën të dy bashkëshortët. Pasi dëgjoi pretendimet e tyre, gjykata krijoi bindjen se pajtimi nuk mund të arrihet dhe bazuar në nenin 135/2 të K.Familjes e 158/c të K.Pr.Civile kaloi çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore në datë 07.09.2023, ora 13:00. Nisur nga fakti që nga martesë kanë një fëmijë të mitur, pavarësisht marrëveshjes së bashkëshortëve, bazuar në nenet 6,155 e 157 të K.Familjes dhe nenin 224/a të K.Pr.Civile, gjykata vendosi marrjen e mendimit nga një ekspert psikolog, duke emëruar me këtë cilësi psikologun Erilda Ajaz.

Në seancën e sotme u paraqit vetëm psikologja Erilda Ajaz por nuk u paraqit asnjë nga kërkuesit. Të dy kërkuesit kishin dijeni për datën dhe orën e seancës gjyqësore, pasi ishin prezent në seancën datë 05.07.2023, ora 09:00, dhe nuk kishin bërë prezent ndonjë shkak në

lidhje me mosparaqitjen. Gjykata verifikoi duke u thirrur bashkëshortët disa herë nga punëtori i gjykatës nëpërmjet mikrofonit, por rezultoi që ata të mos jenë paraqitur. U verifikua sekretarinë e gjykatës dhe nuk ishte bërë prezent ndonjë shkak në lidhje me arsyen mosparaqitjes. Po kështu, m.q.s. kërkesa për gjykim dhe projekt marrëveshja ishin bërë nga avokate Entela Dvorani, nga ana e sekretares së seancës u kontaktua nëpërmjet telefonit dhe avokatja sqaroi se nuk është përfaqësuese e ndonjërit nga kërkuesit dhe as është njohur me tyre në lidhje me ndonjë shkak për mosparaqitjen në gjykim.

Duke qënë në rrethanat si më sipër, referuar nenit 299/ç të K.Pr.Civile i ndryshuar gjykata çmon se duhet të vendoset pushimi i gjykimit, pasi kjo dispozitë parashikon: "Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ç) Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht i ligj". Pushimi i gjykimit për shkak të mosparaqitjes së palëve parashikohet në nenin 179/1 K.Pr.Civile, i cili përcakton se: "Nëse asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, në paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dëjani rregullis gjykata vendos pushimin e gjykimit." Në lidhje me shkaqet, neni 175 i K.Pr.Civile parashikon se: "Pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja nuk janë paraqitur në seancë. Në rast se mosparaqitja është ndodhur për shkak sëmundjeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër". Gjykata hetoi në lidhje me shkaqet e mosparaqitjes dhe rezultoi që kërkuesit nuk kishin bërë prezent asnjë lloj shkak.

Përsa i takon shpenzimeve gjyqësore, kërkuesit kanë parapaguar tarifën mbi-aktet, e cila bazuar në nenin 106 e vijues të K.Pr.Civile, duhet të lihet në ngarkim të tyre.

Nisur nga fakti që midis palëve nuk ka detyrime reciproke, se nuk jemi para rasteve për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit sipas parashikimit të neneve 510 e 511 të K.Pr.Civile ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 179/1 e 299/ç të K.Pr.Civile i ndryshuar,

VENDOSI:

-Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr. regj.23000-00784-41-2023 (1107 datë regjistrimi 23.05.2023, me kërkues Alma Tahirllari dhe Endri Tahirllari, me objekt zgjidhje martesë.

-Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të kërkuesve.

-Kundër këtij vendimi, kërkuesit kanë të drejten e ankimit të veçantë në Gjykatën Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar nga nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

-U shpall në Korçë, sot më datë 07.09.2023.

SEKRETARË
Vitoria HAJCE



GJYQATAR
Seladin PYSOULLI



